



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

KOLEGJI "BIZNESI"
Nr. 558-1/24 Data 01.10.2024
PRISHTINË

RREGULLORE
PËR PUNË KËRKIMORE-SHKENCORE NË KOLEGJIN "BIZNESI"

Prishtinë 2024

Rregullore për punë kërkimore shkencore është hartuar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”, Statutin e Kolegjit neni 21 pika h dhe neni 71, 72 në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi dhe është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor 27/09/2024

Rishikimi i Nenit 1/A të Rregullores për Punë Kërkimore-Shkencore – Shtator 2024

Në kuadër të adresimit të rekomandimeve të dala nga procesi i vlerësimit dhe akreditimit, Kolegji Biznesi ka realizuar rishikimin dhe plotësimin e Rregullores për Punë Kërkimore-Shkencore në muajin shtator 2024, përmes shtimit të Nenit 1/A, i cili përcakton në mënyrë të qartë dhe fleksibile konceptin e punës kërkimore-shkencore në përputhje me misionin dhe profilin akademik të institucionit.

Ky rishikim ka pasur për synim zgjerimin dhe qartësimin e përkufizimit të punës kërkimore-shkencore, duke reflektuar pikat e forta dhe potencialin zhvillimor të institucionit, si dhe duke njohur forma të ndryshme të kërkimit shkencor dhe aplikativ, transferimit të njohurive dhe aktiviteteve profesionale që kontribuojnë në zhvillimin akademik, institucional dhe shoqëror.

Qëllimi i Rregullores për Punë Kërkimore-Shkencore

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë parimet, fushëveprimin dhe mekanizmat institucionalë për organizimin, mbështetjen, zhvillimin dhe vlerësimin e punës kërkimore-shkencore në Kolegjin Biznesi. Ajo synon të krijojë një kornizë të qartë dhe funksionale që mundëson zhvillimin e veprimtarisë kërkimore në përputhje me misionin, profilin akademik, pikat e forta dhe potencialin zhvillimor të institucionit.

Rregullorja përcakton një qasje fleksibile dhe gjithëpërfshirëse ndaj punës kërkimore-shkencore, duke njohur dhe vlerësuar forma të ndryshme të kërkimit shkencor dhe aplikativ, transferimit të njohurive dhe aktiviteteve profesionale që kontribuojnë në zhvillimin akademik, ekonomik dhe shoqëror. Në këtë mënyrë, institucioni synon të inkurajojë angazhimin aktiv të stafit akademik dhe hulumtues në veprimtari kërkimore që janë të përshtatshme dhe të vlefshme për misionin e tij.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është gjithashtu të sigurojë lidhjen ndërmjet kërkimit shkencor, procesit mësimor dhe nevojave të tregut të punës, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programeve studimore, avancimin profesional të stafit dhe rritjen e ndikimit institucional në zhvillimin e shoqërisë dhe ekonomisë.

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet statusi, aktivitetet, struktura, qeverisja dhe procesi i vendim-marrjes në fushën kërkimore-shkencore.

Neni 1/A

Në përputhje me misionin, profilin akademik dhe orientimin profesional të Kolegjit Biznesi, puna kërkimore-shkencore përkufizohet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe fleksibile.

Si punë kërkimore-shkencore konsiderohen, ndër të tjera:

- publikimet shkencore në revista ndërkombëtare të indeksuara në **Scopus** dhe **Web of Science (WoS)**;
- publikimet në revista të tjera shkencore me recensim;
- pjesëmarrja dhe publikimet në **konferenca shkencore ndërkombëtare dhe vendore**;
- projektet kërkimore, zhvillimore dhe aplikative;
- bashkëpunimet kërkimore me institucione akademike, industri dhe organizata të tjera;
- projektet ndërkombëtare dhe iniciativat **Erasmus+**;
- aktivitetet e transferimit të njohurive, inovacionit dhe zhvillimit profesional;
- forma të tjera të veprimtarisë kërkimore që kontribuojnë në zhvillimin akademik, profesional dhe institucional dhe janë në përputhje me misionin e institucionit.

Vlerësimi i punës kërkimore-shkencore realizohet duke respektuar parimet e cilësisë, relevancës, integritetit akademik dhe kontributit real në zhvillimin e institucionit.

Neni 2

Në Kolegjin “Biznesi” do të themelohet një rrjet i entiteteve hulumtuese në kuadër të Kolegjit dhe të secilit departament.

2.1. Forma themelore në kuadër të Kolegjit “Biznesi” për kryerjen e aktiviteteve hulumtuese-shkencore është Instituti për Hulumtime Shkencore e Kolegjit “Biznesi”.

2.2. Formë themelore institucionale e kryerjes së aktiviteteve hulumtuese në kuadër të Kolegjit “Biznesi” është Instituti për hulumtime shkencore.

2.3. Instituti për Hulumtime Shkencore do të ketë njësitë e veta hulumtuese-shkencore dhe botuese. Ajo do të menaxhohet nga drejtori i Institutit për Hulumtime Shkencore i Kolegjit “Biznesi”. Drejtori i Institutit i raporton drejtpërdrejt strukturave menaxhuese dhe akademike të Kolegjit “Biznesi”.

2.4. E tërë veprimtaria hulumtuese-shkencore dhe botuese ka të bëjë me lëmit shkencore që janë objekt studimi në Kolegjin “Biznesi”.

Neni 3

Në Kolegjin “Biznesi” do të themelohen këto entitete apo njësi hulumtuese:

- a. Sektori për hulumtime shkencore Ekonomike-Juridike dhe emergjencave;
- b. Sektori për trajnime dhe zhvillim të stafit akademik.

Neni 4

Këto njësi hulumtuese do të koordinohen nga drejtori i Institutit, në mbikëqyrjen e përgjegjësve të tyre.

Neni 5

Njësitë hulumtuese do të jenë pjesë e Kolegjit “Biznesi”, respektivisht të Institutit të udhëhequra nga drejtori i Institutit, ndërsa të menaxhuara nga përgjegjësit e tyre.

Neni 6

Proporcioni financiar nga projektet e realizuara do të përcaktohet sipas Statutit të Kolegjit “Biznesi” 50 % për Kolegjin, 20 % për zhvillimin e stafit të Kolegjit, dhe 30% për personat e përfshirë në implementimin e projektit.

Deri në fillimin e punës së njërive hulumtuese shpenzimet e punës së tyre do të mbulohen nga buxheti i Kolegjit “Biznesi” për hulumtime shkencore.

Neni 7

Njësitë hulumtuese janë pjesë e Kolegjit dhe nuk janë njësi të ndara ligjore kështu që ato nuk do të kenë mjetet e veta financiare, të ndara nga Kolegji “Biznesi”, pra llogari bankare.

Neni 8

Dy herë në vit (një herë në çdo semestër), në nivel të Kolegjit, stafi i Institutit për hulumtime shkencore do të mbajë mbledhje ku do të shqyrtohen aktivitetet individuale hulumtuese të çdo anëtarit të stafit, si edhe projektet e punës kërkimore-shkencore nëpër departamentet përkatëse.

Neni 9

9.1. Njësitë hulumtuese do të themelohen me vendimet e Këshillit të lartë mësimor-shkencor të Kolegji "Biznesi" të fuqizuara nga dekani i Kolegjit "Biznesi".

9.2. Çdo njësi hulumtuese do të nxjerrë udhëzime të hollësishme procedurale lidhur me organizimin, strukturën dhe funksionimin e saj.

Neni 10

Të gjitha vendimet e Kolegjit "Biznesi", lidhur me themelimin dhe emërimet e Njësive hulumtuese do të aprovohen nga Këshilli i lartë mësimor-shkencor i Kolegjit "Biznesi".

Neni 11

11.1. Në nivel të Kolegjit "Biznesi" do të themelohet Komiteti Këshillëdhënës i Kolegjit për punë kërkimore-shkencore.

11.2. Ky Komitet do të udhëhiqet nga prodekani për punë kërkimore-shkencore dhe do të:

- aprovojë planin vjetor të Kolegjit "Biznesi" për punë kërkimore-shkencore;
- shqyrtojë aktivitetet e propozuara hulumtuese të çdo departamenti;
- shqyrtojë të arriturat individuale hulumtuese të stafit të Kolegjit.

Neni 12

12.1. Ky komitet do të takohet tri herë në vit e sipas nevojës edhe me shpesh.

Neni 13

Në mbledhjen e Komitetit të Kolegjit për punë kërkimore-shkencore çdo përgjegjës i departamentit do të prezantojë planin vjetor për punë kërkimore-shkencore, aktivitetet lidhur me projektet konkrete hulumtuese dhe planet e ardhshme për vitin vijues akademik.

Neni 14

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga organi kompetent i institucionit dhe zbatohet për të gjitha vlerësimet pas hyrjes së saj në fuqi.


Prof. Dr. Shyqer KABASHI